# DËSHMI ARKIVI

**A-432126**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ekskluzive në |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/915040/video-pergjimi-i-publikuar-nga-ahmetaj-po-plackitet-grabitet-delvina-kush-eshte-ermal-raketa-dhe-si-e-mori-pseudonimin/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 23:13:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 19:42:17 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `27ee816ba53058776f37c37aabdde4ce5180857bad5711bfbc7ef52e7815a8b1` |
| TEKSTI | `b3b5f38efe8a123a1919b33a5b6d549a5c501bde5f02aac4afb4f7f4444474b6` |
| PAMJA | `9db09a0844d3e0f7be6255e40a432aaa08a32ed47398e699a4a508efd3c229b8` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bf9464932b6bffb65e261bb2763ff9efaeae0e8f6fb05010a25d4e8d8b928afc` |
| E MËPARSHMJA | `d20da7cb1845eabf47fedcd9437667845afe437c27e42909a8074b18e0317e33` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bf9464932b6bffb65e261bb2763ff9efaeae0e8f6fb05010a25d4e8d8b928afc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

LAJMI I FUNDIT

## LIVE/ 104 ditë protestë, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Ramës

-
-
-
-

# VIDEO/ Përgjimi i publikuar nga Ahmetaj: Po plaçkitet grabitet Delvina. Kush është Ermal Raketa dhe si e mori pseudonimin

**ZMADHO TEKSTIN21:42, 07/09/2026**

± Aª -

*Ish-zv/kryeministri Arben Ahmetaj, gjatë intervistës ekskluzive në 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, ka publikuar një audiopërgjim ku është përfshirë izraelito-shqiptari, Ron Yefet dhe dy qytetarëve, ukrainisht folës dhe rusisht folës.*

*Sipas Ahmetajt, këta të tre po tentojnë të grabisin gazin e Delvinës.*

*Ahmetaj ka zbuluar dhe kush është Ermal Raketa.*

**Pjesë nga intervista ekskluzive:**

**AUDIOPERGJIMI EPISODI 1 :** VIDEO (lart)

**Transkripti**
**Ron:** Siç thamë dje ne do të jemi 80%, qeveria do të jetë 10 ose 20%

**Ron:** Igor do të jetë 80% ose 90 sido që ta vendosim

**Ron:** Dhe më pas ne do të kemi një marrëveshje më vete

**Ron:** Por unë nuk mund të jem në të … formalisht

**Ron:** Ndoshta më vonë situata ndryshon pasi të kalojë në Këshillin e Ministrave të hënën.

**Ron:** Të hënën ose të martën është Këshilli i Ministrave. Dhe më pas do të jemi në kontakt me zv/sekretarin e përgjithshëm të zyrës së Kryeministrisë.

**Tatjana:** Kush është ai.

**Ron:** Ta them unë… Çfarëdo që ne vendosim

**Tatjana** përkthen në gjuhën ukrahinase

**Ron:** Emri i tij është Ermal Nufi. Zv/sekretari i Përgjithshëm, Ermal Nufi do të mbajë kontaktet

**Ron:** Do të jesh ti apo Rafael. Nuk e di kush është përfaqësuesi. Ai do të mbajë kontakt me ju

**Tatjana** përkthen në gjuhën ukrahinase

**Ron:** Nuk do të jetë KAYO… do të jetë I njëjti koncept

**Tatjana:** Ah sigurisht sepse KAYO është te mbrojtja

**Ron:** Korrekt, i njëjti koncept por jo KAYO

**ÇIM PEKA:** Pra, publiku i ka ndjekur dhe nëpërmjet ekranit të titruar në shqip. Tani sqaro pak çfarë është?

**ARBEN AHMETAJ:** Është interesante. Është midis Ron Yefetit dhe dy qytetarëve, ukrainishtfolës dhe rusishtfolës. Njëri prej tyre e ka emrin Igor, por këta nuk janë fokusi im.

Bëhet fjalë për grabitjen e Delvinës me të njëjtin koncept, konceptin KAYO. Shqiptarët duhet ta dinë që kreu i organizatës së bashku me plaçkitësen kanë më shumë se 9-10 muaj që tentojnë të grabisin Delvinën për t'ia dhënë Ron Yefetit.

Koncepti KAYO është: shteti krijon një kompani, siç ka krijuar KAYOn. Dhe pastaj këtu fillojnë gjithë vemjet, joint venture, me 80% vemjet dhe 20% shteti i shkretë. Devijojnë paratë e buxhetit të

shtetit dhe shërbimet pa tender në mënyrë kriminale tek kompanitë bija të KAYOs. Dhe vemjet nuk hedhin asnjë cent.

Do ta shikojmë tek Timak Defense. Këto janë krijesa të Edi Ramës. I lutem deputetëve të partisë time që votuan ligjin e KAYO-s, të mos e ulin kokën, se po ju vjen ligji tjetër në shëndetësi. Është i njëjti koncept KAYO me izraelitin tjetër Sani, që e paska deklaruar dhe në grup, ka thënë 'ministrja iku se nuk firmosi'. Le ta mohojë sa ta dojë, se nga brenda grupit më ka ardhur, por ka thënë se, ne do bëjmë një gjë fantastike pa tender me izraelitin në Shëndetësi. Prandaj ka ikur ministria.

**ÇIM PEKA: Është tjetër izraelit ky?**

**ARBEN AHMETAJ:** Është tjetër izraelit ky. Është influenca e Ron Yefetit. Këtu bëhet fjalë që të grabitet Delvina, madje aty i thotë: 'Nuk keni nevojë për para, ndërtoni pak pjesën teknike se s'ka hedhur asnjë cent'.

Dhe sigurisht që Ermal Raketa, që atë ditë ka qenë zëvendëssekretar i përgjithshëm, që u bë kryetar i bordit të KAYOs, u bë ministër i Mbrojtjes. E mbani mend që zoti Peka, në intervistën e fundit, kam thënë që është ndërruar komandanti i forcave tokësore me qëllim.

Tani do shohim transfertat, paratë e shqiptarëve si u shkojnë miqve, klientëve dhe kreut të organizatës. Unë brenda grupit parlamentar të Partisë Socialiste shoh që nuk ndjehet njeri për plaçkitësen, votojnë këtë ligj kriminal për të vënë duart në kokë.

**ÇIM PEKA: Po pse i quajtur Ermal Raketa?**

**ARBEN AHMETAJ:** Ermal Raketa është pseudonimi që Forcat e Armatosura i referohen ministrit të tyre. Nga brenda më ka ardhur. Kur kreu i organizatës i ka thënë: 'Ermal, ti po më zhgënjen', Ermali çohet në këmbë dhe i thotë: 'Unë për ty bëj dhe raketë!'. E firmos. Dhe Forcat e Armatosura tash kanë filluar i thonë Ermal Raketa.

Kalojmë tek episodi i dytë.

© SYRI.net

**Lexo edhe:**

- VIDEO/ Ahmetaj publikoi përgjimin në SYRI TV, protestuesi: Rama dhe Yeffeti, skema për shitjen e Shqipërisë
- Denoncimi/ Emigrantët shqiptarë bllokohen në Mal të Zi me urdhër të Ramës! Pengohen t'i bashkohen protestës
- VIDEO/ Tomorri ngre dyshime për Timak Defense: Ka deklarata kontradiktore, SPAK duhet të verifikojë

Më të lexuarat
Politikë

## Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në 'raportim të kufizuar', qeveria fshehu të vërtetën

Politikë

## Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit

Politikë

## SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si 'raketë' pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin

Politikë

## SYRI TV/ 'Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz' , Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313

Politikë

## Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Politikë

## Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar

Politikë

## SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

Politikë

## SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën

Politikë

## Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Politikë

## Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija

**TË NGJASHME**

Politikë

## Mediu për 11 Shtatorin: Bota ndryshoi përgjithmonë, shqiptarët krenarë që qëndruan në krah të SHBA

Politikë

## Televizioni francez: Protesta në Shqipëri është shndërruar në një mobilizim afatgjatë kundër modelit Rama

Politikë

## Skandaloze/ Nuri: Rama telefonoi protestuesin në administratë për ta frikësuar se pse proteston

Politikë

## A e ka marrë përsëri Allajbeu konçensionin?/ Diaverum fiton tenderin e dializës, grupi zotëron edhe DiaVita-n e PPP

Politikë

## Berisha denoncon: Ministri i ri i Brendshëm rrihet në zyrë, policia nuk e ndihmon

Politikë

## 'Territorialja' në Memaliaj/ Kryebashkiaku Albert Malaj dhe qytetarët braktis dëgjesën publike: Jo shkrirjes

Politikë

## Ministres pa emër, që i vjen ndot nga e vetmja pasqyrë që u ka mbetur socialistëve

- Lajme
  - Web TV
  - Kuriozitete
  - Arte & media
  - Sociale
  - English
  - Shëndet
  - Tjera
- Politikë
- Kronikë
- Ekonomi
- Kosova
- Botë
  - Rajoni
- Kulturë
- Shkencë
  - Teknologji
- Sport
  - Botërori 2026
- Jetë/stil
- Trashëgimi
  - Histori
- Mjedis
  - Klimë
- Arkiva

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Search

Denonco

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Në rregull

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.